



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Berat më ____ .03.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje Karburanti për nevojat e agjencisë”, si më poshtë:

“Blerje Gazoil 10 ppm”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP)_
09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 12.892.965 (dymbëdhjetë Milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e kualifikimit si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 82-83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse Operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43, pika 2, paragrafi b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, ku përcaktohet se në procedurat ndërmjet kufirit të lartë dhe ulët monetar vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë

Bazohet në nenin 43, pika 2 ,gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar :

- * në nenin 43 pika 1 të VKM 285/2021 ”Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;
- * si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, **2023-2024-2025** që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit **Nr.** 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin **Nr.** 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" , te Ligjit **Nr.** 9920, datë 19.5.2008” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Neni 57), Ligjit **Nr.** 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, si dhe VKM-së **Nr.** 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **Vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizura, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Subjekti duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi, autorizim, ose licencë për tregtim karburanti sipas legjislacionit në fuqi ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, VKM-së nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” I ndryshuar .

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin Nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 germa a, 5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a.licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) Stacion Tregtimi karburanti në territorin e Bashkisë Berat, shoqëruar me dokumentat ligjore, dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë.

Për të vërtetuar disponimin operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Nëse pika e tregtimit të karburantit është në pronësi të jetë e pasqyruar në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB;

Pika e tregtimit të karburantit detyruesisht duhet të jetë e pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë sipas Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet;
- Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Vërtetim teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në stacionet e tregtimit të karburanteve, lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave
- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH

Nëse pika e tregtimit të karburantit është me qira kontrata e qerasë duhet të jetë të paktën me afat 1 (një) vjeçar duke filluar nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës e deri në përfundim të Kontratës.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK-së është bërë duke patur parasysh vendodhjen e objektit të bashkisë, numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe inteneraret ditore të grupeve të terrenit që kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale, dhe se OE veprojnë brenda kornizës ligjore në fuqi lidhur me dokumentacionin përkatës për stacionet e shitjes me pakicë të karburantit.

Në zbatim të VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njesite e Qeverisjes së Përgjithshme” shërbimi i furnizimit me karburant duhet të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike, e cila mundëson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e saj.

Njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e këtij kriteri për operatorët ekonomik ofertues, duke vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ISO 9001:2015, ose ekuivalente (për të vërtetuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë) lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.5. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant, me shërbim 24 orë në çdo stacion furnizimi të tij, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.

Argumentimi : Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme” dhe janë të nevojshëm dhe të arsyeshëm për autoritetin kontraktor, duke përmbushur nevojat sipas standarteve në fuqi si dhe në mënyrë të leverdisshme për AK Agjencia e Shërbimeve Publike.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktin Gazoil 10 PPM S SH EN 590:2022, nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), shoqëruar me Deklaratën Doganore SAD, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 40 pika 6, germë ”c” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

Ky raport fletë-analizë për produktin , krijon siguri qe karburanti te jete me cilesi sipas normave nderkombetare,dhe sipas normave te percaktuara nga ISHTI

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet janë hartuar nga specialisti i fushes anëtar i njësisë së prokurimit , konform legjislacionit të prokurimit në fuqi dhe garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë.

Gazoil-10ppm, sipas Standartit SSHEN 590:2022.

Të dhënat teknike të Gazoil 10 PPM i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022

Specifikimet teknike të Gazoilit (Naftë)

- Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022
- Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

				EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	deri 10.0 (01.01.2009)	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetjedistilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioniishufrësëbakrit (3 orënë 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitëlubrifikuese, diametriikorrektoarinjollëssëg ripar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskozitetinë 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v) distilati që vlon ÷ në 350 °C,%(v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	< 65 360	EN ISO 3405



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

NJESIA E PROKURIMIT

Roland Deda	Personi përgjegjës
Fradiol Droboniku	specialist i fushës
Brikena Halitaj	Specialiste finance

MIRATOHET

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

JOANA MELENGU